

PROCES-VERBAL

I mbajtur sot me datë 18.12.2023, ora 15:00 në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë Alba Road sh.a me NUIS J83211208W , për shqyrtimin e raportit për shndërrimin e shoqërisë nga shoqëri aksionare në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar si dhe për aspekte të tjera të shndërrimit sipas rendit të ditës.

Në mbledhjen e sotme, janë të pranishëm aksionarët si më poshtë:

1. Neritan Malo, zotërues i 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë
2. Stylianos Ydraios, zotërues i 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë

Thirrja e Mbledhjes së Asamblesë është bërë nga administratori rregullisht për të gjithë aksionarët. Aksionarët jo prezent kanë marrë dijeni rregullisht sipas njoftimeve të bëra:

1. Aksionari Konstantinos Ydraios është njoftuar nëpërmjet shkresës me postë me datë 21.11.2023 dhe ka marrë dijeni me datë 23.11.2023 si dhe nëpërmjet e-mailit me datë 24.11.2023 në adresën Kostas.ydraios@yahoo.gr

2. Aksionari Mirela Malo është njoftuar nëpërmjet shkresës me postë me datë 21.11.2023 dhe nëpërmjet e-mailit me datë 24.11.2023 në adresën mirelamalou@yahoo.com

Aksionarët e pranishëm diskutuan mbi të gjitha pikat e rendit të ditës si më poshtë:

REND DITE

1. Miratimi i shndërrimit të formës ligjore të Shoqërisë Alba Road sh.a nga shoqëri aksionare në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
2. Miratimi i raportit të hollësishëm të hartuar nga administratori mbi bazat ligjore dhe ekonomike të shndërrimit, efektet që ai ka për punëmarrësit, pasojat ekonomike, efektet tek organet e shoqërisë, efektet ligjore etj.
3. Miratimi i statutit të ri të shoqërisë Alba Road në cilësinë e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.
4. Autorizimi i administratorit z.Neritan Malo, të kryejë të gjitha veprimet dhe procedurat përkatëse lidhur me shndërrimin e shoqërisë nga sh.a në sh.p.k duke përfshirë ,por pa u kufizuar në depozitimin e dokumentacionit përkatës në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njoftimi i shndërrimit palëve të treta, thirrja me shpallje etj, personalisht apo nëpërmjet autorizimit të palëve të treta.
5. Të tjera.

Bashkëlidhur vendimi i marrë.



Asambleja mbyllet në orën 16:00.

AKSIONARËT

Neritan Malo



Stylianos Ydraios

STILIANOS YDRAIOS



Mbajti procesverbalin,

Ino Xheforaj



VENDIM


Datë 18.12.2023

Ne, aksionarët e shoqërisë Alba Road sh.a, të mbledhur për të shqyrtuar shndërrimin e shoqërisë në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, pas diskutimit dhe shqyrtimit të rendit të ditës si dhe bazuar në nenet 228-229 të Ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, vendosëm:

1. Të miratohet shndërrimi i shoqërisë nga shoqëri aksionare në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
2. Të miratohet raporti i hollësishëm i hartuar nga administratori mbi bazat ligjore dhe ekonomike të shndërrimit, efektet që ai ka për punëmarrësit, pasojat ekonomike, efektet tek organet e shoqërisë, efektet ligjore etj.
3. Të miratohet statuti i ri i shoqërisë Alba Road në cilësinë e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.
4. Të autorizohet administratori z.Neritan Malo, të kryejë të gjitha veprimet dhe procedurat përkatëse lidhur me shndërrimin e shoqërisë nga sh.a në sh.p.k duke përfshirë, por pa u kufizuar në depozitim të dokumentacionit përkatës në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njoftimi i shndërrimit palëve të treta, thirrja me shpallje etj, personalisht apo nëpërmjet autorizimit të palëve të treta.

AKSIONARËT

Neritan Malo



Stylianos Ydraios

